

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje enë kuzhine, makine mishi profesionale dhe frulator.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Loti I- “Blerje enë kuzhine”– 39221120-4, 39221180-2, 39221210-2, 39221220-5, 39221230-8, 39221240-1, 39223000-;

Loti II – “Blerje makina mishi profesionale dhe frulator” - 39312100-3 39711210-4.

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi total – 5 595 500 (pesë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëqind) lekë pa T.V.SH.

Loti I - “Blerje enë kuzhine” me fond limit –3 428 833.33 (tre milion e katërqind e njëzetë e tetëmijë e tetëqind e tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Loti II - “ Blerje makine mishi profesionale dhe frulator” me fond limit - 2 166 666.67 (dy milion njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pike gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Loti I – “Blerje enë kuzhine”.

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron vjetore për 2 vitet e fundit financiare 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, ato i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të Operatorëve Ekonomik dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2. Kopje të çertifikuara të bilanceve vjetore për vitet financiare 2022, 2023 ku bilancet e kërkuar nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.

- Operatori ekonomik për të vertetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, sasi dhe llojin e mallrave të furnizuara.
- Operatori Ekonomik për të vertetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat, sasi dhe llojin e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe **nenin 40, pika 4** (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar nenit 40 pika 4 e VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më të madhe se 20 % të vlerës së perlllogariturvekontrates, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001-2015 ose ekuivalente me të, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësive, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme, e leshuar nga nje organ i akredituar.

Argumentim: Kriteri që OE ofertues duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalente të saj, të vlefshme, per tregtimin e produkteve, konsisiton në kërkesën që ai duhet të zotërojë “Sistemin e menaxhimit të cilësisë” së produkteve që ai tregëton. Referuar Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, “SSH ISO 9001:2015 specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë ku OE duhet të demostrojë aftësinë e tij për të ofruar produkte që plotësojnë kërkesat e AK dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative si dhe ka përqëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit dhe të kërkesave të zbatueshme ligjore dhe rregullative”.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas shtojcës 8 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon 1 mjet transporti me “masë maksimale të autorizuar” jo më pak se 3.5 ton, e cila do të përdoret për lëvrimin e mallrave objekt prokurimi, ne pronësi ose ne perdorim, në momentin e deklarimit si dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit.

Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, duhet të paraqesë dokumentacionin që disponon **1 (një) mjet transporti** me “masë maksimale të autorizuar” jo më pak se 3.5 ton, ne pronësi ose ne perdorim sipas kontrates noteriale, te vertetuar me:

- leje qarkullimi,
 - çertifikate pronësie
 - siguracion (TPL)
 - çertifikatë e kontrollit teknik
- Në rastin kur automjeti është me qera, të paraqesë kontratën noteriale përkatëse si dhe dokumentat e kërkuara të automjetit.

Argumentim: Kriteri që OE ofertues duhet të disponojë një automjet transporti me “masë maksimale të autorizuar” jo më pak se 3.5 ton, për transportin e mallarve objekt prokurimi, është

në funksion të zbatimit të kontratës. Gjatë zbatimit të kontratës, OE fitues në bazë të grafikut të lëvrimit, do të transportojë me automjetet e veta mallrat e kërkuar, në magazinën e DPÇK. Kapaciteti i automjetit të kërkuar është vendosur duke patur parasysh sasinë e konsiderueshme të produkteve të kërkuara, peshën dhe volumin e tyre, në raport me grafikun e lëvrimit të përcaktuar.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **katalogun/fragmente te katalogut te prodhuesit, si dhe skedat teknike.**

Të dhënat teknike të përcaktuar në katalog dhe në skedën teknike duhet të jenë në përputhshmëri të plotë me specifikimet teknike të kërkuara.

Fragmentet e katalogjeve duhet të specifikojnë qartë mallrat që do të ofrohen dhe prodhuesin të cilit ato i përkasin.

Në rastin kur katalogu dhe/ose skeda teknike janë në gjuhë të huaj, ato duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

***Argumentim:** Kriteri që OE ofertues duhet të paraqesë katalogun ose fragmente te katalogut te prodhuesit dhe skedat teknike të produkteve të paraqitura, i shërben AK për të verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të përcaktuara për secilin produkt.*

2.3.5 Ditën e hapjes së ofertave, Operatorët ekonomikë pjesmarrës duhet te paraqesin nga një mostër për çdo artikull të kërkuar sipas specifikimeve teknike te Autoritetit Kontraktor.

Mostrat e kërkuara do paraqiten ne daten dhe oren e hapjes se ofertave, prane DPÇK me adrese Rr. e Barrikadave, Çerdhja nr.1 Tirane.

Mostrat e kerkuara duhet te kene nje etikete e cila te permbaje elementet: moster “emri i artikullit”, daten e zhvillimit te tenderit, emrin e ofertuesit, nenshkrimin dhe vulen e operatorit ekonomik.

Mungesa e mostres eshte kusht skualifikues.

***Argumentim:** Referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 40, pika 6/a. Kriteri i vendosur për paraqitjen e mostrave është kërkuar për të vërtetuar lidhjen midis OE konkurrues në raport me mostrën e paraqitur ditën e hapjes së tenderit dhe dokumentacionit shoqërues të paraqitur në SPE (katalog/skeda teknike), për përmbushjen e kritereve të kualifikimit. Gjithashtu për të vërtetuar plotësimin e kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike ku mostra e kërkuar do të shfaqë cilësinë e produktit final i cili do të lëvrohet nga OE fitues gjatë gjithë zbatimin e kontrates.*

II. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Loti II – “Blerje makina mishi profesionale dhe frulator”

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.1 Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron vjetore për 2 vitet e fundit financiare 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, ato i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të Operatorëve Ekonomik dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2. Kopje të çertifikuara të bilanceve vjetore për vitet financiare 2022, 2023 ku bilancet e kërkuar nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së perlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.

- Operatori ekonomik për të vertetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, sasi dhe llojin e mallrave të furnizuara.
- Operatori Ekonomik për të vertetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat, sasi dhe llojin e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe **nenit 40, pika 4** (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20 % të vlerës së perlllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar nenit 40 pika 4 e VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 20 % të vlerës së perlllogaritur të kontratës, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001-2015 ose ekuivalente me të, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësive, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme, e leshuar nga një organ i akredituar.

Argumentim: Kriteri që OE ofertues duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalente të saj, të vlefshme, për tregtimin e produkteve, konsiston në kërkesën që ai duhet të zotërojë “Sistemin e menaxhimit të cilësisë” së produkteve që ai tregëton. Referuar Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, “SSH ISO 9001:2015 specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë ku OE duhet të demonstrojë aftësinë e tij për të ofruar produkte që plotësojnë kërkesat e AK dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative si dhe ka përqëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit dhe të kërkesave të zbatueshme ligjore dhe rregullative”.

2.3.2. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas shtojcës 8 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon 1 mjet transporti, me masë maksimale të autorizuar jo më pak se 0.5 ton, i cili do të përdoret për lëvrimin e mallrave objekt i këtij loti, në pronësi ose në përdorim, në momentin e deklarimit si dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit.

Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, duhet të paraqesë dokumentacionin që disponon **1 (një) mjet transporti**, me masë maksimale të autorizuar jo më pak se 0.5 ton, në pronësi ose në përdorim sipas kontratës noteriale, të vertetuar me:

- leje qarkullimi,
 - çertifikate pronësie
 - siguracion (TPL)
 - çertifikatë e kontrollit teknik
- Në rastin kur automjeti është me qera, të paraqesë kontratën noteriale përkatëse si dhe dokumentat e kërkuara të automjetit.

Argumentim: - Kriteri që OE ofertues duhet të disponojë një automjet transporti me “masë maksimale të autorizuar” jo më pak se 0.5 ton, për transportin e mallrave objekt i këtij loti, është në funksion të zbatimit të kontratës. Gjatë zbatimit të kontratës, OE fitues në bazë të grafikut të lëvrimin, do të transportojë me automjetet e veta mallrat e kërkuar, në magazinën e DPÇK. Kapaciteti i automjetit të kërkuar është vendosur duke patur parasysh sasinë e konsiderueshme

të produkteve të kërkuara, peshën dhe volumin e tyre, në raport me grafikun e lëvrimit të përcaktuar.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **katalogun/fragmente te katalogut te prodhuesit, si dhe skedat teknike.**

Të dhënat teknike të përcaktuar në katalog dhe në skedën teknike duhet të jenë në përputhshmëri të plotë me specifikimet teknike të kërkuara.

Fragmentet e katalogjeve duhet të specifikojnë qartë mallrat që do të ofrohen dhe prodhuesin të cilit ato i përkasin.

Në rastin kur katalogu dhe/ose skeda teknike janë në gjuhë të huaj, ato duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

***Argumentim:** Kriteri që OE ofertues duhet të paraqesë katalogun ose fragmente te katalogut te prodhuesit dhe skedat teknike të produkteve të paraqitura, i shërben AK për të verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të përcaktuara për secilin produkt.*

2.3.5 Ditën e hapjes së ofertave, Operatorët ekonomikë pjesmarrës duhet te paraqesin nga një mostër për çdo artikull të kërkuar sipas specifikimeve teknike te Autoritetit Kontraktor. Mostrat e kërkuara do paraqiten ne daten dhe oren e hapjes se ofertave, prane DPÇK me adrese Rr. e Barrikadave, Çerdhja nr.1 Tirane. Mostrat e kerkuara duhet te kene nje etikete e cila te permbaje elementet: moster “emri i artikullit”, daten e zhvillimit te tenderit, emrin e ofertuesit, nenshkrimin dhe vulen e operatorit ekonomik.

Mungesa e mostres eshte kusht skualifikues.

***Argumentim:** Referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 40, pika 6/a. Kriteri i vendosur për paraqitjen e mostrave është kërkuar për të vërtetuar lidhjen midis OE konkurrues në raport me mostrën e paraqitur ditën e hapjes së tenderit dhe dokumentacionit shoqëruar të paraqitur në SPE (katalog/skeda teknike), për përmbushjen e kritereve të kualifikimit. Gjithashtu për të vërtetuar plotësimin e kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike ku mostra e kërkuar do të shfaqë cilësinë e produktit final i cili do të lëvrohet nga OE fitues gjatë gjithë zbatimin e kontrates.*

I. Argumentim për hartimin e specifikimeve teknike:

Hartimi i specifikimeve teknike është kryer në përputhje me kërkesat specifike që duhet të plotësojnë materialet dhe enët e kuzhinës, në raport me qëllimin për të cilin ato do të shërbejnë në çerdhe dhe kopshte.

Specifikimet teknike të enëve të kuzhinës janë për shkruar qartë në raport me arsyet e përdorimit të tyre, duke cilësuar materialin nga I cili përbehet secili prej objekteve si dhe parametrat e tyre

Në qoftë se do t'i gruponim materialet e kuzhinës, në këndvështrimin e materialit përbërës të tyre, do të kishim dy grupime kryesore që janë materialet e porcelanit dhe materialet e inoksit. Ndërsa në grupimin e tretë përfshihen materialet ndihmëse në funksion të procesit të gatimit, shërbimit, apo mirëmbajtjes së kuzhinës.

Për sa I përket grupimit të materialeve të porcelanit, për hartimin e specifikimeve teknike të tyre është patur parasysh që specifikimet teknike të sigurojnë produkte cilësore, me teknologji relativisht të lartë përpunimi të porcelanit.

Për produktet prej porcelain është kërkuar që “Të jetë 100 % porcelan, jo me përbërës qeramike, të jetë e zmltuar 2 herë sipas standarteve nderkombetare ose kombetare mbi smaltimin e porcelanit, ose ekuivalentët”. Kjo kërkesë është e rëndësishme sepse këto produkte duhet të garantojnë cilësi dhe standard për vetë faktin se ato do të jenë në përdorim për tju shërbyer fëmijëve të grupmoshave nga 6 muaj deri në 6 vjeç. Ky përcaktim konsiston në vetë karakteristikat teknike të produkteve me material 100% porcelan, të cilat janë të zmltuar dy herë, material dhe process I cili siguron mbrojtje të sipërfaqes së produkteve nga sulmet kimike dhe dëmtimet fizike, për të garantuar karaktersistikat strukturore të nënshtresës por edhe për të përmirësuar pamjen e produktit.

Produktet e inoxit sikurse është përcaktuar në specifikimet teknike do të sigurojë garanci në përdorim nga ndikimet kimike, dëmtimet fizike të sipërfaqes së tyre por do të sigurojë edhe një jetëgjatësi më të madhe të tyre në përdorim.

Në grup artikujt me material inoxi, kryesisht është kërkuar që ato të jenë prodhuar me material inox 18/10. Ky material është materiali më rezistent ndaj gërvishtjeve, çarjeve, dëmtimeve të tjera dhe defekteve sipërfaqësore, dhe për më tepër, ajo që është më e rëndësishme, ky material garanton rezistencën ndaj oksidimit.

Përsa I përket artikujve të tjerë, të cilat janë material ndihmëse në funksion të procesit të gatimit, shërbimit, apo mirëmbajtjes së kuzhinës, specifikimet teknike të tyre janë hartuar në përputhje me rolin që ato luajnë. Përshkrimi I produkteve të kërkuara dhe specifikimet e tyre janë hartuar në përputhje me nevojat e kuzhinave të çerdheve dhe kopshteve, duke patur parasysh procesin e gatimit në zbatim të menisë së miratuar.

Për përcaktimin e përmasave orientuese të secilit produkt, është patur parasysh natyra e funksionimit të produkteve në procesin e përgatitjes për gatim, procesin e gatimit si dhe procesin e shërbimit të ofrimit të ushqimit të fëmijët.

Për të gjithë artikujt e kërkuar janë përcaktuar për masat e tyre orientuese me tolerancat e nevojshme por që nuk ndikojnë në procesin e punës që ato kryejnë.

Për përcaktimin e parametrave teknike të paisjeve “Makina mishi profesionale dhe Frulatorë” dhe hartimin e specifikimeve teknike të tyre, komisioni ka marrë parasysh specifikat e përdorimit të tyre në çerdhe në raport me kapacitetin e nevojshëm të përdorimit të tyre për sasinë e produkteve të kërkuara si rezultat i përdorimit të këtyre paisjeve në zbatim të kërkesave kerkesave që përcakton menuja ushqimore. Duke patur parasysh se këto paisje, në kushinat e çerdheve të Bashkisë së Tiranës, do të përdoren çdo ditë dhe do të përgatisin produkte në funksion të zbatimit të menysë për një numër të madh fëmijësh, ato duhet të jenë të sigurta, të nivelit profesional dhe me jetëgjatësi maksimale.